



Ne bazë të nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe nenit 5 , pika (i) të Ligjit mbi arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, nenit 22, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L- 032 dhe nenit 84 të Ligjit të punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212 të dt.01.XI.2010 Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2012, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN E PUNËS DHE TË MËSIMIT NË SHKOLLAT FILLORE DHE
TË MESME TË ULËTA NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

**RREGULLORE E PUNËS PËR SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË
ULËTA, STAFIN MENAXHERIAL, MËSIMDHËNËSIT, PERSONELIN TJETËR,
NXËNËSIT, SI DHE MASAT DISIPLINORE**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen më për së afërmi të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Rahovecit, mënyra e dhënies së lëndave, mirënjohjeve, shpërblimeve, stimulimeve materiale, procedura e shqiptimit të masave pedagogjike për shkelje të dispozitave ligjore, të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të rendit shtëpiak të shkollës.

Neni 2

Kjo rregullore pretendon të jetë motivuese për rezultate më të mira të nxënësve në procesin mësimor – edukativ dhe në aktivitetet jashtëmësimore.

Neni 3

Kjo Rregullore është obligative për të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Rahovecit.

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në çdo sjellje që ndodhë në:

- oborrit e shkollës, në çdo kohë;
- jashtë oborrit të shkollës, në aktivitete apo ngjarje shkollore;
- jashtë hapësirës së shkollës kur sjellja mund ta dëmtojë autoritetin e duhur disiplinor të shkollës ose të rrezikojë sigurinë e anëtarëve të komunitetit të shkollës, të përçajë komunitetin e shkollës dhe
- gjatë udhëtimeve për në shkollë ose nga shkolla në shtëpi, duke përfshirë, por jo kufizuar, veprime në çdo autobus, furgon shkolle ose transportim publik.

Neni 4

Një kopje e Rregullores duhet të jetë e afishuar në tabelën e njoftimeve të shkollës për t'u njoftuar me të të gjithë nxënësit e shkollës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

Drejtori i shkollës është autoriteti, i cili ka për obligim të sigurojë zbatimin e saj dhe të trajtojë në përputhje me këtë rregullore çdo rast që bie ndesh me të.

Përgjegjësitë e parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje drejtori i shkollës mund t'i

bartë tek zëvendësi i tij, në rastet kur shkolla ka zëvendës drejtorin.

II. Të drejtat dhe përgjegjësit e nxënësit

II.1. Të drejtat e nxënësit

Neni 5

Nxënësi ka të drejtë të marrë mësim dhe edukim në shkollë në kushte normale, të sigurta dhe të përshtatshme shëndetësore, të cilat përcaktojnë kohën për pushim, për aktivitete jashtëmësimore në përputhje me psikologjinë, aftësitë, interesat dhe moshën e tij, si dhe të ndjekë rrugët e format e mundshme, që zbulojnë dhe zhvillojnë prirjet e tij në fushën e shkencës, artit dhe sportit.

Neni 6

Individualiteti dhe dinjiteti njerëzor i nxënësit respektohet; ai mbrohet nga dhuna fizike e psikologjike, diskriminimi e veçimi. Në shkollë janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të nxënësit.

Neni 7

Shkolla do të sigurojë respektimin e të gjitha të drejtave të nxënësit të përcaktuara me dispozitat ekzistuese ligjore (Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L- 032 dhe udhëzimet administrative, lëshuar nga MASHT), në veçanti:

- 1) të shfaqë lirisht mendimin e tij në të gjitha format: me gojë, me shkrim, publikisht në mbledhje apo takime të tjera të organizuara në nivel shkolle ose nga shkolla, pa cenuar të drejtat e të tjerëve në përputhje me mundësitë që jep ligji dhe aktet nënligjore;
- 2) të njihet me të drejtat e tij (dokumentet kombëtare e ndërkombëtare), t'i përhapë ato dhe të kërkojë përbushjen dhe respektimin e tyre prej të tjerëve;
- 3) të marrë pjesë aktive në procesin edukativo-arsimor; të shfrytëzojë labororet, kabinetet, bibliotekën, palestrën e shkollës, kompjuterët, mjediset e pajisje të shkollës, sipas rregullave përkatëse;
- 4) të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme edukative, argëtuese, shkencore, kulturore-artistike, sportive,
- 5) të marrë pjesë në mbledhje të ndryshme të klasës e shkollës. Të shpreh opinionet e veta për procesin mësimor-edukativ, programet mësimore, tekstet shkollore dhe për punën e mësuesve; të informohet për probleme, që lidhen me personin e tij, t'ia paraqesë drejtorit të shkollës dhe kujdestarit të klasës, apo edhe mësimdhënësve probleme, që kanë të bëjnë me të dhe të marrë përgjigje jo më vonë se 30 ditë nga koha e paraqitjes së tyre;
- 6) të zgjedhet dhe të zgjedhë të tjerët në këshilla, shoqata, organizma të ndryshme, që përcaktohen në ligj apo në rregullat e shkollës, si dhe të përfaqësojë interesat e klasës apo të një grupi nxënësish në to. Të anëtarësohet në organizata shoqërore në përshtatje me statusin e tyre, apo në shoqatat shkencore, klube sportive, grupe kulturore-artistike brenda e jashtë shkolle.
- 7) të marrë në kohë (jo më vonë se 10 ditë) nga mësuesi vlerësimin për punimet e tij me shkrim (provime, ese etj), për t'i studiuar e për të reflektuar mbi to.
- 8) në rast të pakënaqësisë, të ketë të drejtën të ankohet për vlerësimin nga mësuesit te kujdestari i klasës, te drejtori i shkollës dhe në organet e tjera profesionale të shkollës;
- 9) kur nxënësi mungon nga mësimi deri në dy javë dhe merr pjesë në aktivitete me karakter garues në nivel komunal, e më gjerë, gëzon të drejtën e arsyetimit të mungesave nga kujdestari i klasës.
10. në bazë të kërkesës së arsyeshme të prindit (nëse është nevoja dhe në dobi të nxënësit), drejtori i shkollës mund t'i jep leje nxënësit deri në dy javë për të munguar nga mësimi - shkolla.

Neni 8

II.2. Detyrat e nxënësit

- 1) të vijë në orarin e caktuar dhe të frekuentojë shkollën çdo ditë;
 - 2) të mbajë qëndrim të drejtë e të kulturuar në shkollë e jashtë saj;
 - 3) të njohë dhe të respektojë detyrimet e përcaktuara në procesin mësimor të shkollës (lëndët, obligimet mësimore për çdo lëndë dhe obligimet javore);
 - 4) të mësojë dhe të përgatitet sistematikisht në çdo lëndë; të kryejë me korrektësi dhe në përputhje me aftësitë e veta detyrat, që i ngarkohen nga mësimdhënësit dhe drejtoria e shkollës,
 - 5) të respektojë rregulloret e shkollës, rendin shtëpiak, ligjet e zbatueshme, të mos pengojë mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në klasë, shkollë apo në aktivitete të tjera jashtëmësimore brenda dhe jashtë shkolle.
 - 6) të respektojë e të mbajë qëndrim korrekt ndaj mësimdhënësve, drejtorisë së shkollës, personelit administrativ, teknik e ndihmës të shkollës, në mjediset brenda e jashtë shkollës;
 - 7) të mbajë higjienën vetjake, të kujdeset dhe të kontribuojë për higjienën e klasës, të shkollës dhe të ambientit të jashtëm të shkollës.
 - 8) janë të obliguar të mbajnë uniformën
 - 9) veshja e paraqitja e jashtme e tij/saj të jetë korrekte, pa teprime, e përshtatshme me moshën që ai/ajo ka, në përputhje me normat e bashkëjetesës në shoqëri dhe me rregulloren e brendshme të shkollës.
 - 10) të mos përdor fjalë të pahijshme, të turpshme apo të pista;
 - 11) të raportojë incidentet apo aktivitetet që mund të kërcënojnë apo të përçajjnë ambientin shkollor tek një nga drejtuesit e shkollës (drejtori, zëvendësdrejtori, arsimtari kujdestar klase, arsimtari kujdestar dite etj.)
 - 12) detyra të tjera konform dispozitave ligjore, rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës. Nxënësit mund të qëndrojnë në shkollë gjatë kohës të caktuar për mësimdhënie, formave të tjera të arsimit, edukimit dhe aktiviteteve të lira gjithmonë në mbikëqyrje të personelit shkollor.
- Nxënësit janë të detyruar të vijnë në shkollë së paku dhjetë minuta para se të fillojë mësimi dhe të largohen nga shkolla posa të përfundojnë aktivitetet edukativo-arsimore.

Neni 9

- Gjatë ndërrimit të mësimimit mund të caktohen dy - katër nxënës kujdestarë, të caktuar nga kujdestari i klasës sipas kriterëve që zgjedhin ata. Këta nxënës duhet të jenë në shkollë së paku 15 minuta para fillimit të mësimimit dhe:
- Vlerësojnë parregullsitë, dëmet dhe mungesat e tjera për zhvillimin normal të mësimimit dhe raportojnë arsimtarin kujdestar të ditës.
 - Mbledhin të gjitha sendet që janë harruar nga ndërrimi tjetër si: libra, fletore, lapsa, rroba e gjësende të tjera dhe i raportojnë arsimtarit kujdestar të ditës.
 - Gjatë pushimeve të shkurta ose të gjata kujdesen për qetësinë dhe rendin shtëpiak, iu tërheqin vërejtjen nxënësve kurse ata të padëgjueshmë i lajmërojnë te arsimtari kujdestar i ditës, rastet e rënda edhe te drejtori i shkollës.
 - Pasi të përfundon mësimi bëjnë edhe një kontroll gjithë ambientit shkollor dhe raportojnë arsimtarin kujdestar, nëse kanë hasur në ndonjë parregullsi ose dëme e informojnë edhe drejtorin ose sekretarin e shkollës, dhe të fundit e lëshojnë shkollën.

III. Stimulimi moral dhe material

Neni 10

Nxënësi gëzon të drejtën e stimulimit moral dhe material për rezultatet e larta të arritura në procesin edukativo-mësimor, në aktivitetet e ndryshme jashtëmësimore shkollore, në aktivitetet me karakter garues në nivel shkolle, komune e vendi, për sjellje shembullore në shkollë dhe jashtë shkolle.

Neni 11

Për nxënësin ka këto stimuj moral e material, sipas rastit:

- 1) lavdërim para kolektivit të klasës;
- 2) lavdërim para kolektivit të shkollës;
- 3) afishimi i fotografisë në tabelën “Nxënës të dalluar”;
- 4) ndarja e Mirënjohjes për nxënës të dalluar;
- 5) dhënia e certifikatës “ Nxënës i dalluar”;
- 6) dhënia e dhuratave të ndryshme, nga fondi i shkollës, DKA-së, pushtetit lokal, komunës, sponsorët e ndryshëm, miq të shkollës, nga organizma, fondacione e shoqata të ndryshme bamirëse;
- 7) dhënia e certifikatës: “ Nxënësi i talentuar në” (psh në sport, matematikë, letërsi, ...) për nxënës që fitojnë në kuize, gara, veprimtari të ndryshme artistike, sportive etj të cilat organizohen nga DKA apo MASHT-i.

Stimuj të tjerë të paraparë me dispozita ligjore dhe sipas propozimeve të DKA-së dhe të MASHT-it.

Lavdërimet, mirënjohjet dhe shpërblimet mund të jepen për:

- nxënësin (personalisht),
- grupit të nxënësve,
- nxënësve të një paraleleje,
- nxënësve të një seksioni apo asociacioni dhe
- shkollës në tërësi.

Neni 12

Për stimulimin në pikën 1 të nenit 10 vendos mësuesi i klasës në nivelin një(kl. I-V), përkatësisht arsimtari kujdestar klase në nivelin dy (kl. VI-IX) ;

Për stimulimin në pikën 2 dhe 3 vendos drejtori i shkollës me propozimin e mësuesit përkatësisht arsimtarit kujdestar dhe me propozimin e Këshillit të nxënësve të shkollës

Për stimulimin në pikën 4 dhe 5 vendos drejtori i shkollës, me propozimin e mësuesit përkatësisht arsimtarit kujdestar klase, Këshillit të nxënësve të shkollës dhe të Këshillit të arsimtarëve të shkollës. Për pikën 5 nxënësi duhet të ketë sukses shembullor në mësim. Të dy këta stimuj (4 dhe 5) ndahen me ceremoni. Certifikatat (mirënjohjet) përgatiten dhe shpërndahen nga drejtorja e shkollës.

Për stimulimin në pikën 7 vendos DKA përkatësisht MASHT-i , varësisht se kush e organizon veprimtarinë (kuizit të diturisë, garave etj.). Certifikatat apo mirënjohjet përgatiten dhe ndahen nga DKA përkatësisht MASHT-i me ceremoni.

Për të gjithë stimujtë moral e material shkolla mban evidencë të veçantë, përpos për stimulimin në pikën një të nenit 10.

IV. Shkeljet e nxënësit dhe pasojat

IV. 1. Shkeljet e nxënësit

Neni 13

Në këtë Rregullore, sjellja e keqe (jo e përshtatshme) e nxënësit ndahet në dy nivele :

- Niveli I i shkeljeve (shkelje e lehtë e rregullave të shkollës);
- Niveli II i shkeljeve (shkelje e rëndë e rregullave të shkollës).

Niveli i shkeljeve dikton ashpërsinë e masës pedagogjike që drejtori i shkollës do ta imponojë. Përveç shkeljeve specifike të shpjeguara më poshtë, drejtori i shkollës ka të drejtë të disiplinonjë çdo nxënës që përziehet në sjellje që nuk janë thënë më poshtë, por kërcënojnë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e të tjerëve ose përçajnë ambientin e të mësuarit në përputhje me dispozitat ligjore ekzistuese.

Shqiptimi i masave pedagogjike ka për qëllim :

- t'i korrektojë sjelljet e palejueshme që i bëjnë dëm personalitetit të nxënësit;
- të krijojë klimë të vulltshme mësimi e pune në shkollë dhe jashtë saj;
- të vërë në mbrojtje ambientin dhe pasurinë shkollë;
- të përfillet dhe të zbatohet ligjshmëria në shkollat tona;
- të respektohen normat e garantuara me Konventa ndërkombëtare

NIVELI NJË (I) I RREGULLAVE

Neni 14

Rregulli 1. Nxënësi do të veprojë në mënyrë të sjellshme kundrejt të gjithë anëtarëve të komunitetit të shkollës. Një nxënës shkel këtë rregull atëherë kur:

- a) dështon t'i bindet udhëzimeve të drejtorit, kujdestarit të klasës, mësuesit dhe anëtarëve të tjerë të udhëheqjes së shkollës;
- b) dështon të ndjek rregullat e vendosura në shkollë;
- c) zotëron ose përdor bip, celular, wolkman ose mjete të tjera telefonike gjatë orëve mësimore ose programeve të shkollës;
- d) gjatë zhvillimit të orës mësimore dhe programeve të ndryshme bënë zhurmë dhe bëhet pengesë për zhvillimin normal të procesit edukativo-mësimor, përkatësisht të programit;
- f) vepron ose bën zhurmë shumë të madhe në korridor ose në godinë;
- g) mungon nga ora mësimore pa një arsyetim të qëndrueshëm;
- h) vjen me vonesë ose ikën nga ora mësimore;
- i) aktivizon alarmin e zjarrit kur nuk ka asnjë kërcënim për zjarr,

Rregulli 2. Zbatimi i kodit të veshjes ;

Nxënësi duhet të vishet në përputhje me normat e përshkruara më poshtë dhe normat e parashtruara në kodin e veshjes të adaptuar nga shkolla, sipas nenit 22, pika 6 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Nxënësi shkel rregullat atëherë kur:

- a) nuk vesh uniformën;
- b) nuk vesh modelin e caktuar të veshjes;
- c) vesh veshje që është numër më i vogël nga masa ose shumë më i madh se sa masa e nxënësit;
- ç) vesh bluza me numër shumë më të madh nga masa, bluza që tregojnë muskujtë ose bluza me litarë;
- d) ekspozon të brendshme ose vesh veshje me rripa të holla ose të tejdukshme;
- e) vesh këpucë në formë çarapeje, shami të larme ose kapele;

Rregulli 3. Ndalimi i ngjyrave dhe simboleve të bandave:

Një nxënës thyen rregullat e kodit të veshjes nëse:

- a) vesh rroba me ngjyra të një bande me qëllim që të tregojë besnikërinë ndaj bandës;
- b) vesh ndonjë artikull veshjeje që përmban një simbol të një bande,

Rregulli 4. Ndalimi i fjalorit ofendues

Nxënësi nuk bën të përdor fjalë (shprehje) ofenduese. Një nxënës shkel këtë rregull nëse :

- a) shan ose përdor fjalë vulgare, të turpshme dhe fyese ose
- b) dërgon ose përcjell ndonjë mesazh ofendues, me orientim seksual ose kërcënues, fotografi ose simbole nga ndonjë burim, tek ndonjë anëtar tjetër i komunitetit të shkollës,

Rregulli 5 Abuzimi i kompjuterit ose privilegjeve të internetit

Nxënësit do të respektojnë privilegjin e përdorimit të kompjuterit që iu është dhënë në shërbim. Një nxënës shkel këtë rregull nëse ai/ajo:

- a) viziton faqe të internetit që përmbajnë material seksual;
- b) dëmton dhe shkatërron të dhënat e një pjesëtari tjetër të komunitetit të shkollës në internet ose në rrjete të tjera;
- c) krijon, transporton dhe shkarkon viruse kompjuteri.

Rregulli 6 Ndalimi i vjedhjes dhe i shkatërrimit të pronës

Nxënësi duhet të respektojë pronën dhe nuk duhet të dëmtojë, shkatërrojë apo ta vjedhin.

Një nxënës thyen këtë rregull nëse shkakton një dëm ose vjedhje të pronës në shumë që nuk e kalon vlerën prej 50 euro me anë të:

- a) lyerjes dhe vizatimit me grafit në objektet e pronës;

- b) dëmtimin ose tentativës për të shkaktuar dëme të pronës;
- c) vjedhjes ose tentativës për vjedhje të pronës në oborrin e shkollës apo në çdo ngjarje të sponsoruar nga shkolla;

Rregulli 7 Ndalimi i bixhozit

Nxënësit nuk duhet të hedhin baste për përfitime personale,

Rregulli 8 : Ndalimi i vënies në rrezik të tjetrit nga pakujdesia

Një nxënës nuk duhet të veprojë në mënyrë të tillë që të neglizhojë shëndetin, sigurinë, mirëqenien e çdo anëtar të komunitetit të shkollës, duke e vënë atë person në rrezik dëmtimi apo lëndimi.

Rregulli 9 : Ndalimi i kërcënimeve

Një nxënës nuk duhet të kërcënojë direkt ose indirekt ndonjë anëtar të komunitetit të shkollës dhe ta frikësoj atë për dëmtim, lëndim apo tallje.

Rregulli 10 : Ndalimi i zënies

Nxënësi duhet t'i shmanget konfrontimeve, që përfshijnë kontakte fizike me cilindo anëtar të komunitetit të shkollës

Rregulli 11 : Ndalimi i zënieve të lehta

Nxënësi nuk duhet të shkaktojë apo tentojë të shkaktojë dëmtime trupore tek asnjë nxënës tjetër apo vizitor.

NIVELI DY (II) I RREGULLAVE

Neni 15

Rregulla 1 : Thyerje të përsëritura të rregullave nga niveli 1 (neni 13)

Nxënësi nuk duhet të bëjë thyerje të shumëfishta të nivelit një. Ky rregull nuk do të konsiderohet i thyer nëse shkolla nuk ka bërë të gjitha ndërhyrjet ndreqëse të duhura në përgjigje të secilës nga këto shkelje.

Rregulla 2 : Ndalimi i shkatërrimit dhe vjedhjes së inventarit shkollor

Nxënësi duhet të mos e dëmtojë, shkatërroj ose vjedhë inventarin shkollor. Nxënësi shkel këtë rregull nëse dëmton ose vjedh pronën në një shumë 20 euro ose më shumë, me anë të :

- a) lyerjes me bojë apo vizatimeve me grafit në pronë;
- b) dëmtimit apo tentimit për dëmtim të pronës së shkollës;
- c) vjedhjes apo tentimit të vjedhjes së pronës së shkollës.

Rregulla 3 : Ndalimi i frikësimit

Nxënësi nuk do të frikësojë ose tremb asnjë nxënës apo anëtar tjetër të komunitetit. Nxënësi shkel këtë rregull nëse :

- a) kërcënon në mënyrë të vazhdueshme një nxënës tjetër ose angazhohet në sjellje dhune në shkollë dhe në aktivitetet e tjera që lidhen me shkollën;
- b) kërcënon një anëtar tjetër të komunitetit të shkollës me dëmtime trupore;
- c) vendos informacione të vazhdueshme në faqe të internetit, në stendën e buletinit, muret e shkollës, gjërat personale të një individi, ose vende të tjera, pa miratimin e këtij individi .

Rregulla 4 : Ndalimi i ngacmimit

Nxënësi shkel këtë rregull në qoftë se kërkon me ngulm favore seksuale apo ngacmime, kërcënon, frikëson ose me fjalë të tjera krijon një ambient të pafavorshëm shkollor për shkak të gjinisë, moshës, racës, ngjyrës, besimit, paaftësisë, statusit socio-ekonomik, bindjeve politike të dikujt tjetër etj.

Rregulla 5 : Ndalimi i ekspozimit të pahijshëm

Nxënësit nuk duhet të tregojë asnjë pjesë të turpshme të trupit të tij/ saj një nxënësi apo anëtari tjetër të komunitetit.

Rregulla 6 : Ndalimi i sulmit të pahijshëm

Nxënësi nuk do të ngacmojë (prek) asnjë pjesë të turpshme të një nxënësi tjetër apo të ndonjë anëtari të komunitetit të shkollës.

Rregulla 7 : Ndalimi i veprimeve seksuale me dëshirë

Nxënësi nuk do të angazhohet në veprime seksuale me dëshirë (të të gjitha llojeve), në terrenet e shkollës ose në ndonjë ngjarje të sponsorizuar nga shkolla.

Rregulla 8 : Ndalimi i veprimtarive seksuale me forcë

Nxënësi nuk do të kryej ose të tentojë të kryej marrëdhënie seksuale me forcë me një nxënësi tjetër ose anëtar të komunitetit të shkollës.

Rregulla 9 : Ndalimi i goditjeve mbi personelin e shkollës

Nxënësi nuk duhet të shkaktoj ose të përpiqet të shkaktojë me dashje, dëmtime fizike ose lëndime asnjë nxënësi apo anëtari të komunitetit të shkollës,

Rregulla 10 : Ndalimi i grabitjes

Nxënësi nuk do të përdor apo të përpiqet të përdor forcën për të vjedhur ose thjesht të vjedhë pronën e një nxënësi apo pjesëtari tjetër të komunitetit të shkollës.

Rregulla 11 : Ndalimi i vënies në rrezik të një tjetri

Nxënësi nuk duhet të angazhohet, ose përpiqet të angazhohet në ndonjë sjellje që rrezikon shëndetin, sigurinë ose mirëqenjen e çdo anëtari të komunitetit të shkollës. Nxënësi e shkel këtë rregull nëse :

- a) ndez një zjarr në territorin e shkollës;
- b) hakmerret ndaj një anëtari të komunitetit të shkollës kur ky i fundit merr pjesë në ndonjë hetim, dëshmi disiplinore etj.
- c) aktivizon alarmin e zjarrit kur s'ka asnjë kërcënim zjarri dhe kur departamenti i zjarrit vjen për ndihmë ose shkolla boshatiset nga nxënësit,

Rregulla 12 : Ndalimi i zotërimit të një arme

Nxënësi nuk do të zotërojë asnjë armë, ashtu siç përcaktohet në fjalorthin e kësaj rregulloreje. Nxënësi shkel këtë rregull edhe nëse nuk ka për qëllim ta përdor një gjë të tillë si armë.

Rregulla 13 : Ndalimi i pirjes së duhanit

Nxënësi në asnjë rast nuk mund të pijë duhan në ambientet e shkollës dhe në aktivitetet e ndryshme të organizuara nga shkolla.

Rregulla 14 : Ndalimi i përdorimit dhe shpërndarjes së drogës ose alkoolit

Nxënësi nuk bënë në asnjë mënyrë të përdor (konsumojë) drogën, alkoolin ose barëra (pa recetë të mjekut) ose të zotërojë artikuj të tillë në çfarëdo rrethane në shkollë dhe në aktivitetet e ndryshme të organizuara nga shkolla.

V. Masat Pedagogjike (edukativo – disiplinore) dhe organet që i shqiptojnë

Neni 16

Ndaj nxënësit (nxënësve) për shkelje të rregullave të niveleve I dhe II të kësaj rregulloreje mund të shqiptohen këto masa pedagogjike:

- vërejtje me gojë;
- vërejtje me shkrim,

- ulja e notës së sjelljes,
- humbja e privilegjës për të marrë pjesë në aktivitetet jashtëmësimore
- transferim prej një paralele në paralelen tjetër (brenda shkollës)
- pezullimi nga shkolla për tri ditë,
- transferim në një shkollë tjetër,

Neni 17

Masa pedagogjike “vërejtje me gojë” jepet në rastet kur nxënësi bën shkelje të rregullave nga neni 13 i kësaj rregulloreje.

Masën pedagogjike vërejtje me gojë e shqipton mësuesi përkatësisht arsimtari kujdestar.

Neni 18

Masa pedagogjike “Vërejtje me shkrim” nxënësit i jepet në rastet e përsëritura të shkeljeve të rregullave nga neni 13 i kësaj rregulloreje.

Kjo masë pedagogjike jepet nga drejtori i shkollës me propozimin e mësuesit, arsimtarit kujdestar klase, këshillit të klasës, këshillit të arsimtarëve dhe të këshillit të nxënësve të shkollës.

Masa pedagogjike lexohet para nxënësve të shkollës.

Neni 19

Masa pedagogjike “Ulje e notës së sjelljes” nxënësit i jepet për shkelje të vazhdueshme të rregullave të nivelit I, sidomos në rastet:

- e mungesave të paarsyeshme nga mësimi;
- për ikje nga orët mësimore;
- për ardhjen me vonesë në shkollë;
- për përdorim të fjalorit ofendues ndaj komunitetit të shkollës;

Masa pedagogjike “Ulja e notës së sjelljes” jepet nga drejtori i shkollës me propozimin e mësuesit të klasës, arsimtarit kujdestar klase, këshillit të klasës, këshillit të arsimtarëve dhe këshillit të nxënësve dhe e njëjta lexohet para nxënësve të shkollës.

Neni 20

Masa pedagogjike “Humbja e privilegjit për të marrë pjesë në aktivitetet jashtëmësimore”, nxënësit i shqiptohet për shkelje të rregullave të nivelit II përkatësisht të nenit 14 pika 2, 3, 4, 5, 10.

Këtë masë pedagogjike e jep drejtori i shkollës me propozimin e mësuesit përkatësisht arsimtarit kujdestar, këshillit të klasës, këshillit të arsimtarëve ose të këshillit të nxënësve.

Neni 21

Masa pedagogjike “Transferim prej një paralele në paralelen tjetër”, nxënësit i jepet për shkelje të përsëritur, të rregullave nga niveli II konform nenit 14 të kësaj rregulloreje.

Kjo masë pedagogjike jepet nga drejtori i shkollës me propozimin e arsimtarit kujdestar klase, këshillit të klasës, këshillit të arsimtarëve dhe këshillit të nxënësve të shkollës.

Neni 22

Masat pedagogjike ndaj nxënësit jepen në mënyrë graduale, pos në rastet kur kemi të bëjmë me shkelje të rregullave nga niveli II, ku drejtori i shkollës mund t’i shqiptojë masën pedagogjike nxënësit në përputhje me rregulloren, por pa aplikuar shkallë-shkallshmërinë.

Çdo masë pedagogjike shqiptohet pas një pune të gjërë edukative paraprake, duke përfshirë informimin me kohë të nxënësit për detyrat, përgjegjësitë, sanksionet (ndëshkimet) e mundshme dhe të drejtat.

Neni 23

Masa pedagogjike e shqiptuar dë të ketë kuptim dhe efekt nëse përcaktohet me maturi,

duke patur parasysh efektin dhe kundër-efektin, moshën psikologjinë, personalitetin e nxënësit dhe peshën e shkeljes së rregullave të shkollës.

Asnjë masë pedagogjike nuk mund t'i shqiptohet nxënësit nëse atij nuk i është mundësuar të paraqet mbrojtjen e tij.

Neni 24

Me masat pedagogjike, të cilat shqiptohen ndaj nxënësit, njoftohet me shkrim edhe prindi i tij në afat brenda 8 ditësh nga dita e shqiptimit të masës pedagogjike.

Neni 25

Propozimi për ndërmarrjen e ndonjë mase pedagogjike bëhet jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga bërja e gabimit ose të informimit për bërjen e gabimit.

Neni 26

Masat pedagogjike vlejné për një kohë të caktuar dhe ato mund të pezullohen nëse organi që e ka shqiptuar këtë masë konstaton se janë arritur efektet edukative për të cilat edhe është shqiptuar ajo.

Masa pedagogjike nuk mund të bartet në vitin e ardhshëm shkollor

Neni 27

Kur drejtori i shkollës vihet në dijeni se nxënësi ka bërë shkelje të rregullave të nivelit II, neni 14 pika 8, 9, 11, 12, 14, automatikisht ndaj nxënësit të till aplikon masën pedagogjike “Pezullim (suspendim) nga shkolla deri në tri ditë.

Neni 28

Para aplikimit të kësaj mase pedagogjike, drejtori i shkollës e fton në bisedë nxënësin ndaj të cilit shqiptohet kjo masë, e njofton atë për masë dhe në të njejtën kohë merr opinionet e tij rreth masës së shqiptuar dhe arsyen pse ka bërë një veprim të till (shkelje të rregullit).

Masa pedagogjike në fjalë bëhet publike duke u lexuar para nxënësve të shkollës. Me të njejtën masë pedagogjike njoftohen të gjithë arsimtarët e shkollës.

Neni 29

Me masën njoftohet edhe prindëri i nxënësit. Gjatë kohës sa zgjatë pezullimi tre ditor, drejtori i shkollës organizon një takim (mbledhje) me nxënësin e pezulluar dhe prindin e tij, për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për të dy palët. Me masën pedagogjike njoftohet edhe DKA-ja në Rahovec.

Neni 30

Në rastet kur drejtori i shkollës vihet në dijeni për shkeljen e rregullave të nivelit II, neni 14 pika 12 dhe 14 krahas masës së pezullimit tre ditor nga shkolla, duhet ta informojë edhe policinë dhe mundësisht të konfiskoj armën përkatësisht mjetet narkotike (drogën, barnat etj).

Neni 31

Nëse shkolla i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e lartshënuara dhe nuk janë arritur nivelet e kërkuara të përmirësimit të sjelljeve të nxënësit, si brenda në shkollës ashtu edhe në veprimtaritë e tjera të organizuara nga shkolla, dhe kur qëndrimi i tij i mëtejshëm në këtë shkollë dëmton imazhin e shkollës, paraqet rrezik për sigurinë e pjesëtarëve të komunitetit të shkollës (nxënësve dhe punëtorëve), drejtori i shkollës duhet të parashtrij kërkesën me shkrim në DKA-në në Rahovec për transferimin e nxënësit në një shkollë tjetër.

Krahas kërkesës me shkrim për transferimin e nxënësit në një shkollë tjetër, shkolla-drejtori duhet të ofrojë të dhëna në formë të shkruar (raport të shkurtër) ku do të përshkruhet aktiviteti i organeve të shkollës (arsimtarit kujdestar klase, këshillit të klasës, drejtorit) për zgjidhjen e rastit dhe të përshkruhen sjelljet (veprimet) e nxënësit, të cilat bien ndesh me rregullat e shkollës.

Neni 32

Para marrjes së vendimit lidhur me rastin, mundësisht, duhet të bëhet një dëgjim i nxënësit dhe prindit të tij nga një zyrtar i DKA-së.

Prindi i nxënësit gëzon të drejtën e kundërshtimit në vendimin e DKA-së për transferimin e nxënësit në një shkollë tjetër, në afatin brenda 8 ditësh, nga dita e marrjes së vendimit në Komisionin për Ankesa në komunën e Rahovecit. Kundërshtimi i mundshëm nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 33

Organi që shqyrton ankesën e parashtruar të nxënësit, përkatësisht prindit, mund të:

- vërtetojë masën e shqiptuar,
- hedhë poshtë masën e shqiptuar (në mungesë të provave të duhura dhe të aplikimit të gabueshëm të dispozitave të kësaj rregulloreje) dhe
- të zëvendësojë masën e shqiptuar me ndonjë masë tjetër më të lehtë.

Neni 34

Organet që propozojnë dhe shqiptojnë masën pedagogjike, e kanë për obligim ta përcjellin efektin e kësaj mase tek nxënësi dhe nëse konstatojnë se masa pedagogjike ka pasur efekt përmirësues dhe e ka arritur qëllimin, për çka është shqiptuar, mund të propozojnë zbutjen apo shfuqizimin e saj.

Neni 35

Shqiptimi i masës nuk guxon të jetë i motivuar e as të rrjedh si pasojë e:

- hakmarrjes;
- frikësimit;
- nënçmimit;
- lëndimit të personalitetit – dinjitetit të nxënësit;

Neni 36

Masa pedagogjike nuk mund t'i shqiptohet gjithë klasës.

VI. Kompensimi i dëmit material të shkaktuar

Neni 37

Për dëmtime të qëllimshme të inventarit apo të pasurisë tjetër shkollore, e cila e kalon vlerën prej 20 euro, e pas identifikimit të fajtorit dhe vërtetimit të fajësisë së tij, kërkohet dëmshpërblimi adekuat nga prindi i nxënësit që e ka shkaktuar dëmin. Vlera e dëmit të shkaktuar caktohet nga Këshilli Drejtues i shkollës në përputhje me çmimin e tregut.

Neni 38

Nëse prindi i nxënësit refuzon të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar, ndaj tij, nga drejtori i shkollës duhet të fillojë procedura pranë gjykatës përkatëse.

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PUNËTORËVE TË SHKOLLËS

Neni 39

Të gjithë punëtorët e shkollës (personeli udhëheqës, bashkëpunëtorët profesional (pedagogu-psikologu) , punëtorët administrativ, teknik, medicinal (çerdhe) etj. i gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre, të cilat i takojnë në bazë të Ligjit, akteve nënligjore, Kontratës së punës, rregullave të shkollës, në veçanti gëzon të drejtë në :

- lirinë e organizimit dhe të tubimit sipas Ligjit;
- lirinë e fjalës sipas Ligjit;

Neni 40

- Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë për arsye reale apo të supozuara që kanë lidhje me gjininë, racën, prirjen seksuale, gjendjen civile, ngjyrën, fenë, opinionet politike, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, personat me dëmtime fizike dhe mendore;

Neni 41

- Të drejtën sipas Ligjit në pushim ditor, javor, vjetor, pushime të tjera me pagesë, pushime pa pagesë, kompensimin për punën e bërë (e drejta në pagë), kompensimin për punë më të gjatë se orari i punës dhe të drejta të tjera;

Neni 42

- Lirinë e organizimit sindikalist të përcaktuar me Ligj, në përputhje me statutin e organizatës sindikale të shkollës;

Neni 43

- Të drejtën e mbledhjeve të organizatës sindikale në mjediset e shkollës, jashtë orarit të mësimëve; afishimin në vende të caktuara të mjedisit shkollor të njoftimeve, lajmërimeve, peticioneve, kërkesave, aktiviteteve të tjera me karakter sindikalist.

Neni 44

Asnjë punëtor i shkollës nuk mund të dënohet për shkelje të obligimeve të punës nëse më parë nuk i është tërhequr vërejtja nga ana e Drejtorit të shkollës ose nuk i është dhënë mundësia e paraqitjes së rastit.

Neni 45

Punëtorët e shkollës kanë të drejtën të kundërshtojnë në Komunë (DKA), çdo vendim apo veprim të drejtorit të shkollës për të cilin mendojnë se është në kundërshtim me Ligjin, në lidhje me ta.

Neni 46

Punëtorët e shkollës kanë të drejtë të kundërshtojnë çdo vendim apo veprim të Komunës apo MASHT-it lidhur me ta në Gjykatën e Juridiksionit përkatës.

DETYRAT E DREJTORIT TË SHKOLLËS

Neni 47

- 47.1. Siguron që shkolla të jetë një mjedis mësimor miqësor, i sigurtë dhe i këndshëm për nxënësit;
- 47.2. Siguron ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit në shkollë dhe llogaridhënies së mësimdhënësve;
- 47.3. Siguron që kultura e përgjithshme e shkollës dhe atmosfera në klasë të kontribuojnë në kultivimin e vlerave dhe qëndrimeve të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë;
- 47.4. Siguron mundësitë për mësimdhënie të diferencuar si në kuadër të aktiviteteve kurrikulare ashtu edhe të atyre jashtëkurrikulare;
- 47.5. Administron në mënyrë efektive fleksibilitetin dhe autonominë e shtuar për planifikimin dhe zbatimin e Kurrikulës në përputhje me kushtet specifike të personelit mësimor, infrastrukturës së shkollës dhe specifikave të lokalitetit në të cilin vepron shkolla;

47.6. Punon, në bashkëpunim me palët e interesit, drejt zhvillimit të një koncepti të qartë për shkollën, përfshirë vizionin dhe misionin e shkollës e po ashtu edhe mënyrat se si parasheh shkolla të përmirësojë cilësinë, barazinë, dhe llogaridhënien mbi cilësinë e shërbimeve arsimore ;

47.7. Angazhohet për shkëmbimin e përvojave të mira, përballimin e sfidave dhe për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e evidentuara gjatë procesit të zbatimit të Kurrikulës;

47.8. Mundëson bashkëpunimin e shkollës me shërbimet e tjera të fëmijëve në mënyrë që të përkrahen nxënësit për të kapërcyer vështirësitë në të nxënë dhe pengesat e nxënësve për vijimin e shkollës;

47.9. Siguron respektimin e parimeve të demokracisë së shkollës, përfshirë nxënësit, prindërit dhe bartësit e tjerë të arsimit në vendimarrjen në nivel të klasës dhe shkollës;

47.10. Siguron që rregullat dhe procedurat e funksionimit të shkollës të jenë të qarta dhe transparente;

47.11. Siguron respektimin e llogaridhënies ndaj palëve të interesuara, komunitetit dhe autoriteteve të arsimit.

Neni 48

Shërbimi profesional i shkollës: Shërbimi pedagogjik, psikologjik, etj. (pedagogu, psikologu, sociologu)

48.1 Mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme performancën e personelit edukativ, identifikon nevojat për përkrahje dhe siguron mbështetjen e nevojshme profesionale;

48.2 Siguron bashkëpunimin e nevojshëm ndërmjet mësimdhënësve dhe planifikimin e përbashkët të përvojave të të nxënës;

48.3 Këshillon personelin menaxhues të shkollës për planifikimin e angazhimit të mësimdhënësve dhe planifikimin e përbashkët të përvojave të të nxënës;

48.4. Këshillon personelin menaxhues të shkollës për planifikimin e angazhimit të mësimdhënësve;

48.5. Identifikon nevojat për angazhimin e ekspertëve të jashtëm në shkollë;

48.6 Identifikon mundësitë për shfrytëzimin e shërbimeve të tjera publike në funksion të realizimit sa më efektiv të Kurrikulës së re;

48.7 Evidenton në mënyrë të vazhdueshme progresin e shkollës drejt zbatimit të Kurrikulës, sfidat dhe zgjidhjet e bëra në nivel shkolle;

48.8. Organizon procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve me rastin e përfundimit të shkollëve të Kurrikulës dhe në bashkëpunim me personelin mësimor, planifikon programet mbështetëse (mësimi plotësues dhe shtues) në nivel shkolle;

48.9 Administron procesin e shkëmbimit të përvojave ndërmjet shkollave.

DETYRAT E SEKRETARIT TË SHKOLLËS

Neni 49

49.1. Mban me përgjegjësi evidencën në librin amë të nxënësve të shkollës;

- 49.2. Lëshon vërtetime dhe shkresa të tjera në bazë të evidencës, sipas kërkesave të palëve dhe urdhërave të Drejtorit të shkollës;
- 49.3. Mban procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit të arsimtarëve dhe Këshillit Drejtues;
- 49.4. Mban regjistrin e veçantë për nxënësit, të cilët mbarojnë shkollën;
- 49.5. Kujdeset dhe ndihmon për statistikën që përpilohet për nevojat e administratës së shkollës dhe organet e arsimit;
- 49.6. Kujdeset për listën e nxënësve dhe procedurat e tjera gjatë regjistrimit të nxënësve në klasë të I-rë (parë) dhe të gjithë nxënësve për çdo fillim të vitit shkollor;
- 49.7. Mban evidencën dhe bën sistemimin e procesverbaleve të riprovimeve;
- 49.8. Kujdeset dhe mbikëqyrë punën e personelit tekniko-shërbyes;
- 49.9. Mban vulën e shkollës dhe është përgjegjës për përdorimin e saj;
- 49.10. Në fund të vitit shkollor, bënë arkivimin e dokumentacionit pedagogjik dhe shkollor;
- 49.11. Lëshon dublikate të dëftesave për nxënës;
- 49.12. Ndihmon Drejtorin e shkollës dhe është përgjegjës në menaxhimin e buxhetit;
- 49.13. Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga Drejtori i shkollës.

TË DREJTAT E MËSIMDHËNËSIT

Mësimdhënësi ka të drejtë :

Neni 50

- 50.1. Të shfaq opinionet e veta për probleme të punës edukativo-arsimore në shkollë, planet dhe programet mësimore, tekstet mësimore – shkollore, për veprimtarinë, përvojat, problemet e shqetësimet e klasës, lëndës mësimore dhe shkollës; për veten, kolegët, drejtuesit e shkollës, për arsimin e komunitetit ku punon e jeton, për rrethinën e tij dhe në shkallë vendi;
- 50.2. Të marrë pjesë në: mbledhjet e ndryshme të klasës, shkollës, në seminare, takime, konsulta, analiza, tryeza të rrumbullakta, aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës, në mbledhje me prindër, me komunitetin dhe pushtetin lokal apo të organeve e institucioneve të tjera të interesuara për shkollën kur ai ftohet , por pa cenuar orarin e mësimëve.
- 50.3. Të kualifikohet dhe rikualifikohet në varësi të kërkesave të MASHT-it;
- 50.4. Të zgjedh metodat dhe mekanizmat e përshtatshme për realizimin e punës edukativo-arsimore duke u bazuar në aftësitë dhe përgatitjen e tij profesionale,
- 50.5. Të zgjidhet, të zgjedhë të tjerët në organizmat udhëheqëse dhe profesionale të shkollës, që veprojnë në shkollë konform ligjit dhe akteve nënligjore dhe të përfaqësojë në to interesat e një grupi të mësimdhënësve të shkollës kur autorizohet prej tyre;

Neni 51

- 51.1. Të kërkojë nga organet kompetente të shkollës (drejtorin e shkollës, këshillin drejtues etj.) të shqyrtohen çështje që shqetësojnë klasën, shkollën, mjedisin social, komunitetin ku vepron.
- 51.2. Mësimdhënësi gëzon të drejtën të trajtohet me dinjitet, me respekt, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme nga kushdo, pa presion, pa padrejtësi, pa fyerje, pa poshtërime, pa denigrime, pa dhunë.
- 51.3. Të gjitha të drejtat e tjera, të cilat i takojnë në bazë të Ligjit, akteve nënligjore, vendimeve të ndryshme të organeve kompetente, kontratës së punës.
- 51.4. Kur mësimdhënësi mungon nga puna për një kohë të caktuar, drejtori i shkollës dhe DKA-ja marrin masa për plotësimin e orëve të tij të mësimi konform dispozitave ligjore.

DETYRAT E MËSIMDHËNËSVE

Neni 52

Kuadri arsimor:

52.1. Përdor një varg metodash , përshtatur kontekstit dhe nevojave, interesimeve dhe mundësive të nxënësve;

52.2. Përzgjedh përmbajtje relevante për nxënësit dhe planifikon proces të integruar mësimor, duke marrë në konsideratë lidhjen mes lëndëve dhe fushave të Kurrikulës;

52.3. Inkurajon nxënësit që të zgjerojnë horizontin e tyre dhe që të jenë më të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e ndryshme në jetë, në mësim dhe në punë;

52.4. Përgjatë gjithë punës me nxënës kujdeset që të integrojë çështjet dhe përvojat mësimore, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kryesore;

52.5. Merr pjesë në zhvillimin e planeve e programeve dhe materialeve mësimore të veçanta, e po ashtu edhe në përgatitjen e planeve fleksibile mësimore në pajtim me parimin e autonomisë së shkollës;

52.6. Identifikon problemet, vështirësitë, por edhe afinitetet e nxënësve në të nxënë dhe siguron mbështetjen e individualizuar të nxënësve;
Organizon mësim plotësues dhe shtesë në bazë të vlerësimit të rezultateve të arritjes së nxënësve përfundimtar (me rastin e përfundimit të vitit shkollor);

52.7. Aplikon vlerësimin për të nxënësit, me qëllim që t'iu ofrojë nxënësve në mënyrë të vazhdueshme informata kthyesë mbi progresin/ ngecjet si dhe udhëzime, motivim dhe mbështetje për punë të mëtejme;

52.8. Komunikon me prindërit për të siguruar angazhimin e nevojshëm për nxitjen e përparimit të nxënësve;

52.9. Angazhohet në punë ekipore dhe bashkëpunon me aktivin profesional në planifikimin për këmbimin e përvojave në procesin e të nxënësit, në vlerësimin e progresit të vazhdueshëm të nxënësve dhe të arritjeve në fund të shkallëve të Kurrikulës.

Mësimdhënësi ka për detyrë:

Neni 53

53.1. Të ketë paraqitje të rregullt dhe korrekte dhe të paraqitet në shkollë 15 minuta para fillimit të orarit mësimor;

53.2. Të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të klasës, Këshillit të arsimtarëve dhe aktivitetit profesional;

53.3. Të kompensojë orët e humbura të mësimit, pavarësisht nga arsyet e humbjes së tyre;

53.4. Të zbatojë me përpikëri rregullat për vlerësimin e nxënësve dhe shkallën e arritshmërisë;

53.5. Të njohë, të respektojë dhe të mbrojë ligjin si qytetar; të zbatojë me korrektësi legjislacionin shkollor;

- 53.6. Të vlerësojë e të realizojë rolin, përgjegjësinë dhe misionin fisnik që ai ka si mësimdhënës dhe edukator;
- 53.7. Në punën e tij ta karakterizojë pasioni, krijimtaria dhe humanizmi, të kontribuojë për demokratizimin e jetës dhe tërë procesit shkollor,
- 53.8. Të sillet në mënyrë të kulturuar, me etikë demokratike e profesionale, me respekt dhe tolerancë, pa fyerje e pa dhunë brenda dhe jashtë shkollës;
- 53.9. Të njohë mirë lëndën apo lëndët që jep në shkollë, kërkesat shkencore e pedagogjike që përcaktojnë programet e teksteve mësimore, si dhe tekstet e mësuesit, të përdorë instrumentet, aparaturat, teknikat laboratorike, metodikat e praktikave profesionale etj.;
- 53.10. Të hartojë dhe të dorëzojë, në afatin e caktuar nga drejtoria e shkollës, një kopje të planeve mësimore dhe të punës edukative në drejtorinë e shkollës, planprogramet vjetore, planprogramet mujore, përgatitjen me shkrim për orët mësimore;
- 53.11. Të azhurnohet në vazhdimësi me informacione të reja shkencore, psikologjike e pedagogjike, të vetë-kualifikohet dhe të kualifikohet për procedime e mekanizma didaktike më të përparuara që shtron koha;
- 53.12. Të realizojë një përgatitje sistematike ditore, të strukturuar dhe të dokumentuar të orëve të mësimi, të realizojë me kompetencë, përgjegjësi dhe me efikasitet sa më të lartë punën edukativo-mësimore;
- 53.13. Të nxit pavarësinë e mendimit e të veprimit individual e të lirë të nxënësit gjatë punës mësimore-edukative në klasë dhe jashtë saj;
- 53.14. Të zbatojë me korrektësi detyrat specifike të mësuesit kujdestar, orari mësimor të caktuar nga drejtori i shkollës dhe të paraqitjes në shkollë;
- 53.15. Të marrë pjesë, të ndihmojë, sipas rastit e mundësive në organizimin e aktiviteteve jashtëshkollore, konkurseve dhe olimpiadave, të kontribuojë kur është i zgjedhur në organizmat kolegjinale të shkollave apo në mbledhje e analiza të ndryshme me diskutime e propozime konkrete për mbarëvajtjen e punës mësimore-edukative;
- 53.16. Të zbatojë me korrektësi kriteret, procedurat e rregullat e caktuara ligjore kur është caktuar në komisionet e provimeve në shkollë, konkurset e ndryshme në nivel shkolle e më gjerë;
- 53.17. Të kujdeset për mirëmbajtjen, pasurimin dhe përdorimin me efikasitet të bazës materiale, didaktike, laboratorike, të mbaj përgjegjësi për atë që ka në ngarkim deri në zhdëmtim (kompensim);
- 53.18. Mësimdhënësit i ndalohej që për çështje e nevoja të tij private, të largojë nxënësin nga procesi mësimor. Nxënësi nuk mund të nxirret jashtë nga klasa në asnjë rast;
- 53.19. Mësimdhënësit i ndalohej të bëjë kurse private me nxënësit e tij;
- 53.20. Mësimdhënësit i ndalohej të pijë duhan në korridore dhe mësonjëtoje (klasa) të shkollës;

- 53.21. Mësimdhënësit i ndalohet përdorimi i pijeve alkoolike gjatë orarit të punës (mësimi);
- 53.22. Mësimdhënësit i ndalohet përdorimi si dhe shpërndarja e të gjitha drogave narkotike;
- 53.23. Të mos vonohet apo të lëshojë orën mësimore para kohe;
- 53.24. Të mos mungojë nga puna. Çdo mungesë nga puna duhet ta lajmërojë me kohë tek drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij;
- 53.25. Të mos merret në shkollë me veprimtari, biseda dhe propagandim politik;
- 53.26. Të mos përdor shprehje fyese, dhunë fizike apo psikike ndaj nxënësve;
- 53.27. Të plotësojë me kohë dhe me pedanteri rubrikat përkatëse në Librin (Ditarin) e klasës, të plotësojë me kohë dokumentacionin tjetër pedagogjik-shkollor (Librin Amë të nxënësve, dëftesat dhe librezat e nxënësve, të dorëzojë me kohë raportet statistikore për nxënësit etj.);
- 53.28. Të mos ngacmoj seksualisht asnjë nxënës të shkollës;
- 53.29. Të mos kërkojë apo inkurajojë një romantikë apo lidhje të përshtatshme me ndonjë nxënës të shkollës në mënyrë verbale, shkrimore apo kuptime fizike;
- 53.30. Të mos përdor shprehje fyese ndaj udhëheqësit të shkollës, mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollës;
- 53.31. Të mos inkurajojë nxënësit të marrin pjesë në aktivitetet politike, të mos e ndërpresë orën mësimore për qëllime politike;
- 53.32. Nuk duhet që në mënyrë të pakujdesshme apo me qëllim të keqpërdor, falsifikoj apo të le pas dore informatat e regjistrave zyrtar si: kualifikimet, shërbimet akademike, historinë kriminale apo të punësimit, notimit të nxënësve përfshirë këtu administrim të papëlqyeshëm, të cilët do të testohen me standarde duke ndryshuar përgjigjet, kopjuar etj. arsyet për mungesë nga pushimi, informatat e paraqitura për një kërkesë (hetim zyrtar) etj.;
- 53.33. Të mos mitoset, të pranojë beneficion apo korrupsion, të mos dëmtojë fondet e grumbulluara nga prindërit dhe nxënësit e shkollës, të paraqet në mënyrë të rrejshme të dhënat për mbulimin e shpenzimeve apo pagesave;
- 53.34. Të ruaj sekretin e punës së vet si : regjistrat shkollor dhe disiplinor të nxënësve, fshehtësinë personale, informatat shëndetësore dhe mjekësore, problemet familjare dhe sociale, rezultatet e vlerësimit (notimit) – testimit të nxënësve;
- 53.35. Në vendin e punës nuk guxon të vijë me armë;
- 53.36. Të raportojë për çfarëdo thyetje apo thyetje të dyshimtë të Ligjit, akteve nënligjore, kodit të mirësjelljes, rregullave të shkollës e cila vjen në dijeni të tij, dështimi i raportimit të tillë do të jetë i konsideruar vetë sjellje e papërshtatshme dhe mund të ndikojë në masa disiplinore,
- 53.37. Si dhe detyra të tjera konform Ligjit, akteve të tjera nënligjore

MËSIMDHËNËSVE NUK IU LEJOHET

Neni 54

Mësimdhënësit i ndalohej;

- 54.1. Përdorimi i shprehjeve fyese për nxënësit si dhe përdorimi i dhunës fizike dhe psikike ndaj tyre;
- 54.2. Ardhja në shkollë nën ndikimin e alkoolit dhe përdorimi i alkoolit gjatë orarit të punës;
- 54.3. Të pijë duhan gjatë orës së mësimi si dhe ambientet e tjera;
- 54.4. Të bëjë ndryshime në orarin e mësimi pa pëlqimin e Drejtorisë;
- 54.5. Të bëjë propagandë partiake, politike dhe fetare tek nxënësit në lokalet e shkollës;
- 54.6. Të marrë iniciativa, të cilat bien ndesh me punën edukativo-arsimore apo legjislacionin dhe rregullat që rregullojnë lëmin e arsimit në përgjithësi;
- 54.7. Të bëjë keqpërdorim gjatë vlerësimit të nxënësve me nota;
- 54.8. Të falsifikojë dokumente dhe korrigjojë notat e nxënësve pas mbylljes së tyre;
- 54.9. Të përdorë telefonin celular gjatë orës së mësimi;
- 54.10. Të mbledhë të holla nga nxënësit, përveç në rastet kur ekziston urdhër nga Drejtori i shkollës për rastet kur është marrë vendim në nivel të shkollës për destinime të caktuara të aprovuara nga Drejtoria e shkollës.

DETYRAT E KUJDESTARIT TË KLASËS

Neni 55

Detyrat specifike të mësimdhënësit- kujdestar klase janë:

- 55.1. Mësimdhënësi, kujdestar i klase është një mësimdhënësi i shkollës, i cili ngarkohet që të kujdeset për një klasë të caktuar dhe ta ndihmojë atë në punën mësimore edukative gjatë një viti shkollor,
- 55.2. Mësimdhënësin kujdestar klase e cakton Drejtori i shkollës, për çdo klasë, jo më vonë se 5 ditë para datës së fillimit të mësimëve në vitin shkollor,
- 55.3. Drejtori i shkollës për këtë mban përgjegjësi ciklet, vijimësinë dhe interesat e përgjithshme të mbarëvajtjes së punës mësimore edukative brenda dhe jashtë shkolle,
- 55.4. Të ndihmojë për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative të klasës, të bashkërendojë punën, ngarkesat dhe veprimtaritë e klasës me të gjithë mësimdhënësit e tjerë që japin mësim në atë klasë,
- 55.5. Të njohë mirë psikologjinë, veçoritë, interesat dhe prirjet e secilit nxënësi të klasës në kujdestari,
- 55.6. Të sigurojë rregull, disiplinë, frymë demokratike, harmoni dhe marrëdhënie të ngrohta, miqësore me nxënësit dhe ndërmjet tyre, të luftojë veset, veprimet e pahijshme dhe të ndaluar konform ligjit, udhëzimeve administrative, kësaj rregulloreje dhe rendit shtëpiak të shkollës.
- 55.7. Të kujdeset për mirëvajtjen e librit të klasës, sipas rregullave të plotësojë dokumentacionin përkatës shkollor të klasës që ka në kujdestari (librat amë të nxënësve, dëftesat, librezat etj).
- 55.8. Të sigurojë partneritet të frytshëm e konstruktiv me prindërit e nxënësve në dobi të procesit mësimor edukativ, t'i informojë ata rregullisht me rezultatet mësimore, edukimin, sjelljet e fëmijëve të tyre,

- 55.9. Partneriteti me prindër sigurohet me anë të mbledhjeve me prindër, bisedave individuale, letrave informuese, vizitave në familje, bisedave telefonike dhe forma të tjera,
- 55.10. Jep leje dhe justifikon mungesat e nxënësve të klasës që ka në kujdestari konform Ligjit dhe akteve nënligjore,
- 55.11. Harton dhe ndjek realizimin e planit edukativ për klasën që ka në kujdestari,
- 55.12. Kujdeset për realizimin e planprogramit mësimor për secilën lëndë mësimore, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, kushtet e punës, organizimin e piknikëve, shëtitjeve, ekskursioneve të klasës që ka në kujdestari,
- 55.13. Në fillim të çdo jave mësimore cakton nxënësit kujdestar të klasës,
- 55.14. Në fillim të vitit shkollor në bashkëpunim me nxënësit e klasës, zgjedhë kryesinë e nxënësve të klasës,
- 55.15. Në fillim të vitit shkollor mban mbledhjen me prindër dhe konstituon kryesinë e prindërve në nivel paraleleje ku është kujdestar klase,
- 55.16. Gjatë vitit shkollor, në bazë të planit vjetor të punës së shkollës (planit të bashkëpunimit me prindër), mban mbledhje me prindërit e nxënësve të klasës së vetë,
- 55.17. Kryen edhe punë të tjera konform Ligjit, akteve nënligjore dhe rendit shtëpiak të shkollës.

DETYRAT E ARSIMTARIT SI KUJDESTAR DITE NË SHKOLLË

Neni 56

Mësimdhënësit kujdestarë të ditës, apo nxënësit- kujdestarë të ditës, mbikëqyrin dhe zbatojnë rendin ditor prej fillimit të mësimit deri në mbarim.

- 56.1. Mësimdhënësit kujdestar dite vijnë në shkollë së paku 20 minuta para fillimit të mësimit;
- 56.2. Gjatë pushimeve gjenden gjithmonë në mesin e nxënësve e duke bashkëpunuar me nxënësit kujdestarë të ditës;
- 56.3. Të gjithë kujdestarët interesohen për mirëvajtjen e punës dhe disiplinës në shkollë si dhe kujdesen për respektimin me përpikëri të orarit për fillimin dhe mbarimin e çdo ore mësimore;
- 56.4. Kujdestarët veçanërisht interesohen për ruajtjen e pasurisë shkollore;
- 56.5. Nëse mungon ndonjëri nga mësimdhënësit e shkollës, në koordinim me drejtorin, sigurojnë zëvendësimin. Po që se nuk është i mundur zëvendësimi, kujdesen që klasa përkatëse të angazhohet me ndonjë punë, duke siguruar që rendi e disiplina në shkollë mos të prishet;
- 56.6. Pas mbarimit të mësimit, kujdestarët e ditës konstatojnë gjendjen nëpër klasa e mjedise të tjera dhe konstatojnë numrin e ditëve në sallën e arsimtarëve;
- 56.7. Në librin e veçantë (librin e kujdestarisë) shënojnë rrjedhat e punës në shkollë,

emrin e mësimit, që eventualisht ka munguar nga mësimi, është vonuar në orët e mësimit, dëmtimin eventual të inventarit shkollor si dhe çdo gjë me rëndësi që ka ndodhur atë ditë në shkollë dhe informojnë Drejtorin e shkollës;

Nëse kujdestari i ditës, për arsye të ndryshme, nuk evidenton në librin (fletoren) e kujdestarisë ditore: vonesat, mungesat dhe parregullsitë që kanë ndodhur gjatë kohës sa ai/ajo ishte kujdestar dite, si dhe elementet e tjera që ndikojnë në destabilizimin e procesit mësues, atëherë Drejtori i shkollës është i obliguar të marrë masa të parë edukative ndaj kujdestarit të ditës: *Vërejtje me shkrim*.

56.8. Njëri nga punëtorët teknik bënë kujdestari, kohë pas kohe, në oborrin e shkollës, udhëzon dhe orienton palët në mjediset ku kanë punë;

56.9. Nxënësit kujdestarë vijnë në shkollë (mësim) së paku 15 minuta para fillimit të mësimeve. Ata duke bashkëpunuar me mësuesin kujdestarë dite, kujdesen veçanërisht për:

- ruajtjen e orendive dhe pajisjeve shkollore, sepse ato janë edhe të tyre;
- bëjnë pastrimin e dërrasës së zezë dhe sjelljen me kohë të shkumësave;
- bëjnë ajrosjen e dhomave të mësimit gjatë pushimeve midis orëve;
- sjellin me kohë mjetet e konkretizimit të nevojshëm për mësim;
- nxënësit kanë të drejta, por edhe përgjegjësi.

Fjala e tyre duhet dëgjuar. Askujt nuk i lejohet nëpërkëmbja e të drejtave dhe lirive të nxënësve të garantuara me dispozita ligjore dhe me Konventa ndërkombëtare.

DETYRAT E PUNËTORËVE TEKNIK

Neni 57

Detyrat e punëtorëve teknik janë:

- 57.1. Të paraqitet me kohë në punë, sipas orarit të cilin e përpilon Drejtori i shkollës;
- 57.2. Të kujdeset për mirëmbajtjen, ruajtjen dhe meremetimin e objektit shkollor;
- 57.3. Përgjigjet për dëmtimet eventuale që bëhen në shkollë e që janë të lidhura me punën dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre;
- 57.4. Çdo mëngjes, para fillimit të orarit mësues, bëjnë pastrimin e tërë objektit shkollor, përfshirë bankat e klasave dhe sallën e arsimtarëve;
- 57.5. Të pastrojnë korridoret e shkollës pas çdo ndërimi dhe pas mbarimit të mësimit;
- 57.6. Të bëjnë pastrimin e tualeteve pas çdo pushimi, në mes të orëve të mësimit, pas mbarimit të ndërrimeve dhe pas mbarimit të orarit të mësimit;
- 57.7. Të pastrojnë të gjitha klasat, kabinetet dhe sallën e edukatës fizike pas mbarimit të mësimit;
- 57.8. Të pastrojnë oborrin e shkollës;
- 57.9. Në fund të javës të bëjnë pastrimin e përgjithshëm të objektit shkollor;

MASAT DISIPLINORE PËR ARSIMTARË

Neni 58

Për moskryerjen dhe shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi, mësuesin mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore:

- 58.1. Vërejtje me gojë;
- 58.2. Vërejtje me shkrim;
- 58.3. Për orët e humbura për një muaj, të shndërrohen në ditë pune dhe për këto të bëhen ndalesa nga paga mujore dhe atë një ditë pune = me një mëditje (- përqindja e pagës mujore);
- 58.4. Për mungesë të përgatitjes me shkrim për orën mësuese mund t'i shqiptohet masa disiplinore- vërejtje me shkrim;

- 58.5. Për mungesë të përgatitjes së planit mujor mund t'i shqiptohet masa disiplinore, ndalesë në lartësi prej 2 % e pagës mujore;
- 58.6. Ndalesë e rritjes së pagës për një vit;
- 58.7. Ndërprerje e kontratës së punës;
- 58.8. Për mos respektimin dhe shkeljen e detyrave të punës shqiptohen masa që ruhen në dosjen e arsimitarit. Për shkelje të lehta shqiptohen vërejtje interne. Për shkelje të rënda shqiptohen vërejtje sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 44/2002, të Dt. 24 gusht 2004.

MASAT DISIPLINORE PËR PUNËTORËT TEKNIK

Neni 59

Masat disiplinore që mund t'iu shqiptohen punëtorëve teknik për shkeljen dhe moskryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;

- 59.1. Vërejtje me gojë;
- 59.2. Vërejtje me shkrim;
- 59.3. Ndalesë për mungesë të paarsyeshme nga puna, për një ditë pune në lartësi prej 2% %e pagës mujore;
- 59.4. Për moskryerjen e detyrave, ndalesë prej 5 % të pagës mujore;
- 59.5. Ndalesë të rritjes së rrogës deri në një vit;
- 59.6. Ndërprerje të kontratës së punës.

DETYRAT E BIBLIOTEKISTIT TË SHKOLLËS

Neni 60

60.1. Përgjigjet për pasurimin e bibliotekës shkollë me tituj të ri të librave dhe sigurimin e fondit të mjaftueshëm të librave si dhe planifikimin e shfrytëzimit të këtij fondi nga nxënësit;

- 60.2. Bashkëpunon me nxënësit e shkollës në motivimin e nxënësve për të lexuar në mënyrë të përhershme;
- 60.3. Kujdeset për mirëmbajtjen e evidencës së librave dhe azhurimin e saj;
- 60.4. Kryen detyra të tjera të caktuara nga Drejtori i shkollës;
- 60.5. Respekton orarin e punës në bibliotekë.

DETYRAT E ROJTARËVE TË SHKOLLËS

Neni 61

- 61.1. Përgjigjet për sigurinë dhe sigurimin e objektit të shkollës, pajisjeve dhe tërë pasurisë së shkollës;
- 61.2. Kryen detyra të tjera specifike, të cilat ia cakton Drejtori i shkollës;

MARRËDHËNIET RECIPROKE NË MES TË NXËNËSVE

Neni 62

Në marrëdhëniet e tyre, nxënësit:

- Duhet të ofrojë ndihmë për nxënësit e tjerë të shkollës,
- Duhet të japin këshilla të përshtatshme për nxënësit e tjerë në pajtim me interesat e tyre,
- Janë të detyruar të lejojnë nxënësit tjerë të shprehin mendimin e tyre,
- Të informojnë nxënësit tjerë në lidhje me ngjarjet në shkollë,
- Nuk guxojnë t'i pengojnë nxënësit tjerë gjatë zhvillimit të mësimin ose aktiviteteve tjera edukative- arsimore, kulturore dhe sportive.
- Mund të propozojnë krijimin e shoqatave të nxënësve,
- Të respektojnë dhe të nxisin barazinë gjinore, sociale dhe vendbanimit të tyre.

- Mund të propozojnë krijimin e formave të ndryshme të kulturës, sportive artistike, dhe atraksione të tjera.

Neni 63

Mosmarrëveshjet midis nxënësve nuk mund të zgjidhën me grindje dhe goditje, fyerje, duke përhapur gënjeshtër, etj

Në raste të konflikteve të ndryshme duhet të kërkohet ndihma nga organet e shkollës: Arsimitari kujdestar klase, kujdestar dite, drejtori shkollës nëse nuk arrihet pajtueshmëri.

MARRËDHËNIET RECIPROKE NË MES TË NXËNËSVE DHE MËSIMDHËNËSVE

Neni 64

- Nxënësit janë të obliguar të sillen në mënyrë njerëzore ndaj arsimtarëve dhe punonjësve të tjerë të shkollës

- Nxënësit janë të obliguar t' i përshëndesin punonjësit e shkollës në mjedisin e shkollës dhe jashtë saj.

- Nxënësit janë të obliguar të përshëndesin personat që hyjnë në klasë gjatë mësimin, po ashtu dhe të tjerët që gjenden në ambientet shkollore.

Neni 65

Nxënësit janë të obliguar t'iu japin përparësi të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, të sëmurëve etj.

Neni 66

Nxënësit, vetëm me leje, mund të hynë në dhomën e personelit, sallën e arsimtarëve, drejtorit dhe sekretarit të shkollës.

Para se të hynë në klasë ose hapësira të tjera në kohën e mësimin, nxënësi duhet së pari të trokas, dhe pastaj në heshtje të hyjë dhe të informojë arsyen për praninë. Pasi ta kryejë detyrën që ka, me lejen e pranuesit del jashtë.

Neni 67

Librat amë, ditarin e klasave vetëm arsimtarët mundë t' i bartin në klasa e kurrsesi nxënësit. Askujt nuk i lejohet që librat amë dhe ditarët e klasave t' i bartin jashtë ambienteve të shkollës (bartja jashtë shkolle konsiderohet vepër penale, njëkohësisht dhe shkelje e rëndë e vendit të punës).

Neni 68

Mësuesi nuk mund të urdhëroj nxënësit që të largohen nga klasa.

Ndëshkimi i largimit nga ora mësimore është i ndaluar.

SIGURIA DHE MBROJTJA NË SHKOLLË

Neni 69

Punëtorët e shkollës, në bashkëpunim me nxënësit, janë të obliguar që të sigurojnë qëndrim të sigurt dhe punë normale në shkollë.

Të gjithë punëtorët e shkollës janë përgjegjës në pajtueshmëri të obligimeve dhe detyrave të caktuara me ligj, rregullore të shkollës, kontratave të punës dhe detyrave shtesë të përcaktuara nga drejtori i shkollës.

Neni 70

Vendi dhe kohëzgjatja e detyrës përcaktohet nga drejtori i shkollës dhe vendoset në tabelën e njoftimeve ose me shkrim personalisht punëtori i shkollës.

Neni 71

- Arsimtari Kujdestar i ditës ka detyra dhe obligime shtesë për mirëvajtjen e mësimit dhe aktiviteteteve të tjera në shkollë.
- Është i obliguar të vijë në punë së paku 20 minuta para fillimit të mësimit dhe ta lëshojë shkollën i fundit në ndërrimin e tij.
- Së bashku me punëtorin tekniko-ndihmës dhe kujdestarët nxënës të ndërrimit nëse ka, kujdeset për hyrjet dhe daljet e punëtorëve, nxënësve dhe palëve të tjera në ambientet shkollore.
- Kujdesen për dëmet, mungesat e mjeteve të nevojshme, ngrohjen e pastërtinë e lokaleve shkollore, vonesat dhe mungesat e arsimtarëve, incidentet, ngatërresat nëse ndodhin, kujdesin ndaj fatkeqësive elementare që mund të shkaktohet nga personeli ose nxënësit e shkollës si dhe një varg detyra dhe obligime të tjera të rastit.
- Së bashku me drejtorin e shkollës kujdeset për kodin etik të personelit dhe nxënësve të shkollës.

Neni 72

Në një vend të dukshëm duhet të vendosën numrat e telefonit të policisë, zjarrfikësve, ambulancës, FSK-së, drejtorit dhe sekretarit të shkollës.

Neni 73

Në Shkollë janë të ndaluara të gjitha format e dhunës, grupimet dhe propagandat armiqësore, keqpërdorimi i detyrave zyrtare, përfitimet në kurriz të pronës së shkollës apo personelit tjetër ose nxënësve në shkollë, dhe sjellje të tjera të papërshtatshme në kundërshtim me rendin shtëpiak dhe kodin etik.

Secili është i obliguar të informojë personat që kryejnë shkelje të paligjshme në pajtueshmëri me paragrafin 1 të këtij neni.

Për personat që shkelin këtë nen merren masa ndëshkimore sipas rregulloreve të shkollës, po ashtu lajmërohet dhe në organe të policisë kur e kërkon nevoja

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 74

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi të Rregullores mbi rendin shtëpiak, pushojnë të gjitha rregulloret e mëhershme.

Neni 75

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas shpalljes.

Neni 76

Këshillat drejtues obligohen që brenda 3 muajsh të përpilojnë rregulloren e brendshme të shkollave, të mbështetur në këtë rregullore.

01 Nr. 1676
Rahovec, 30.03.2012

Kryesuesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa

